



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA / MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCEVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME / DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES / DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE / DIVISION OF HUMAN RESOURCES / DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës L. Nr. 03/L-149, Ligjin Nr. 02/L-59 për Filharmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës dhe Statutin e Filharmonisë së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

## KONKURS

**Institucioni:** Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

**Titulli i punës:** Drejtor i Filharmonisë së Kosovës

**Kategoria funksionale / Koeficienti:** 9.5

**Numri i referencës:** 57/2017

**Departamenti:** Departamenti i Kulturës

**Institucioni:** Filharmonia e Kosovës

**I përgjigjet:** Drejtorit të Departamentit të Kulturës

**Vendi:** Prishtinë

**Detyrat dhe përgjegjësitë:** Nën mbikëqyrjen e Drejtorit të Departamentit të Kulturës, përmbush detyrat e poshtëshënuara:

1. Udhëheq punën e Filharmonisë së Kosovës;
2. Përfaqëson dhe përgjigjet për veprimtarinë materiale-financiare si dhe ligjshmërinë dhe afarizmin e Filharmonisë së Kosovës;
3. Miraton programin vjetor të punës me pëlqimin paraprak të Këshillit Drejtues;

4. Propozon dhe nxjerr aktin për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe aktin për shpërndarjen e pagave, të cilin e miraton Këshilli Drejtues;
5. Merr vendime në lidhje me marrëdhënien e punës së punëtorëve në pajtim me ligjin;
6. Ka të drejtë dhe detyrë të merr pjesë në punën e Këshillit Drejtues dhe komisioneve e trupave të tjera, pa të drejtë vote;
7. Mbikëqyr punën dhe aktivitetet artistike të trupave artistike dhe këshillëdhënëse (të përhershme dhe të përkohshme), në pajtim me Ligjin;
8. Kryen edhe punë të tjera lidhur me ecurinë e punëve të Filharmonisë, në pajtim me kete ligj dhe me akte të tjera nënligjore.

**Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:**

1. Njohuri dhe përvojë substanciale në menaxhimin e institucioneve;
2. Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhim;
3. Shkathtësi në caktimin e objektivave, planifikim të punës dhe analizë;
4. Shkathtësi në organizim të ekipit, aftësi për të menaxhuar një ekip ose një grup punues;
5. Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
6. Diplomë universitare, në fushën e artit dhe kulturës, 7 vite përvojë pune profesionale, përfshirë së paku 4 vite, në pozitë drejtuese.

**Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:** Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin e lartë adekuat dhe kanë aftësi profesionale për kryerjen e detyrave.

**Akte ligjore dhe nënligjore që rregullojnë mandatin:** Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës L. Nr. 03/L-149, Ligji Nr. 02/L-59 për Filharmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës dhe Statuti i Filhamonisë së Kosovës.

**Kohëzgjatja e mandatit: 3 vjet.**

Konkursi është i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë.

**Data e mbylljes së konkurrimit: 24.10.2017**

**Paraqitja e kërkesave:** Aplikacioni merret dhe dorëzohet në zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Terezë" Nr. 44, Prishtinë. Për informata shtesë kontaktoni në numrin 038211921 dhe 038211449( apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org/>).